

VENDIM
Nr.66, datë 28.1.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KAVAJË TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Kavajë të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Kavajë të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.301, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Kavajës të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Kavajës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Kavajë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1,2,10,19,20	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës.	Në pronësi
113-117,119,121-126	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
156	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
127-151	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
320-322	Varrezat publike.	Në pronësi
385,386,388,389,392	Infrastrukturë (troje të lira).	Në përdorim
323-366,367-384,387,390,391,393,394,395-689	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
33	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
159-197	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomike.	Në pronësi
35-49	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
243,245	Prona që përdoren për ushtrimin e	Në përdorim

	funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	
239,244	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
308	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi